



UDHËZUES

PRAKTIKË PËR MBROJTJEN CIVILE



Mbështetur nga: Projekti RESEAL i UNDP në Shqipëri





UDHËZUES

PRAKTIKA TË MIRA TË MBROJTJES CIVILE

Së bashku Përgatitemi, Së bashku Mbrojmë!

© 2025 – Materiali është publikuar dhe është pronë intelektuale
e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC),
mbështetur nga projekti
Reseal – UNDP Albania dhe financuar nga Qeveria Suedeze.

Mbështetur nga: Projekti RESEAL i UNDP në Shqipëri





Ky udhëzues synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe përgatitjen e qytetarëve për përballimin e rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore.

Duke ndjekur këto udhëzime dhe duke u informuar vazhdimisht, mund të kontribuoni në një komunitet më të sigurt dhe më të përgatitur.

Për ndihmë të mëtejshme ose për të marrë materiale shtesë, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni autoritetet lokale të mbrojtjes civile ose të vizitoni faqen zyrtare të:

www.akmc.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

TËRMETET		7
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
PËRMBYTJET		10
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
ZJARRET NË PYJE		14
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
RRËSHQITJET E TOKËS		17
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
BLOKIMET NGA RESHJET E DENDURA TË DËBORËS DHE ORTEKËT		19
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
AKSIDENTET TEKNOLOGJIKE		20
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
EPIDEMITË		22
Çfarë duhet të dimë dhe çfarë duhet të bëjmë?		
ÇARJA E DIGAVE		24

Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj shumë rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore, biologjike, teknologjike dhe industriale, të cilat përfshijnë përmbytjet, tërmetet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, ortelet e dëborës, por edhe emergjencat shëndetësore dhe industriale.

Këto rreziqe përfshijnë çdo ditë strukturat tona të mbrojtjes civile: një sistem i përbërë nga institucione, profesionistë, vullnetarë dhe komunitete që punojnë së bashku për të parandaluar, sa më shumë të jetë e mundur, pasojat dhe për të përgatitur qytetarët.

Qëllimi është i përbashkët, por mund të arrihet vetëm nëse secili prej nesh, duke u ndjerë pjesë aktive e këtij sistemi, vepron me përgjegjësi në përditshmëri dhe në raste emergjente.

Fushata kombëtare “Mbrojtja Civile në turne – Praktika të mira për mbrojtjen civile” i drejtohet çdo qytetari me bindjen se çdo veprim i vogël i përditshëm kontribuon në ndërtimin e një shoqërie më të përgatitur dhe më të qëndrueshme përballë rreziqeve.

Nëse i njeh rreziqet në zonën ku jeton, nëse di ku të informohesh dhe si të organizohesh për të përballuar situatat e vështira, mund të ndihmosh jo vetëm veten, por edhe të tjerët.

Shfletu materialet tona për të njohur më mirë rreziqet që të rrethojnë, për të mësuar çfarë duhet të bësh menjëherë në rast paralajmërimi ose gjatë një emergjence.

Ndaje këtë informacion me familjen tënde, me miqtë dhe kolegët – mbrojtja civile fillon nga secili prej nesh.



TËRMETI



Shqipëria është një vend me rrezik të lartë sizmik, për shkak të pozicionit të saj gjeografik ndërmjet pllakës afrikane dhe asaj euroaziatike.

Edhe pse nuk është e mundur të parashikohet saktësisht se kur dhe ku do të ndodhë një tërmet, historiku na tregon zonat më të ekspozuara dhe shkallën e dëmit që mund të pasojë.

Rreziku rritet ndjeshëm për shkak të ndërtimeve pa leje ose me standarde të ulëta, të cilat shpesh nuk respektojnë kriteret bazë të sigurisë sizmike.

Vendosja e godinave në zona me risk të lartë, pa studim gjeologjik, përbën një kërcënim serioz për jetën e njerëzve dhe pronën.



Çfarë duhet të dish?

Në çfarë zone jeton

Shqipëria është një vend sizmik, por me rrezikshmëri të ndryshme; për këtë arsye, është e ndarë në zona.

Kush ndërton apo modifikon strukturën e shtëpisë apo biznesit të tij duhet të respektojë normat sizmike për të mbrojtur jetën e banorëve. Për të ditur në cilën zonë sizmike ndodhet territori ku jeton, drejtohu zyrave përkatëse vendore.

Siguria e shtëpisë tënde

Është e rëndësishme të dish se kur dhe si është ndërtuar shtëpia jote, mbi çfarë lloj terreni dhe me cilat materiale, dhe sidomos nëse është modifikuar më pas duke respektuar normat sizmike. Nëse ke ndonjë dyshim, ose për të mësuar më shumë, kontakto një teknik të specializuar.

Çfarë duhet të bësh?

Me këshillën e një tekniku

Ndonjëherë mjafton të forcosh muret mbajtëse ose të përmirësosh lidhjet ndërmjet mureve dhe dyshemesë; për të bërë zgjedhjen e duhur, është mirë të këshillohesh me një teknik të specializuar.

E bën vetë, menjëherë

- largo mobiliat e rënda nga krevatet dhe divanet
- fikso në mur raftet, bibliotekat dhe mobiliat e larta; var edhe pikturat dhe pasqyrat me grep që nuk lejojnë rënien nga muri
- vendos objektet e rënda në raftet më të ulëta të mobilieve; për ato të larta mund të përdorësh shirita ngjitës për t'i fiksuar
- në kuzhinë, përdor kapëse që parandalojnë hapjen e dollapëve që përmbajnë gota apo pjata, për të mos rënë gjatë lëkundjeve
- mëso të mbyllësh rubinetat e gazit, ujit dhe çelësin kryesor të energjisë elektrike
- përgatit një kuti emergjence me, për shembull: kopje të dokumenteve, mjetet e ndihmës së shpejtë, elektrik dore, radio me bateri, etj.
- identifiko vendet më të sigurta në shtëpi ku mund të strehohesh gjatë një tërmeti
- informohu për planin e mbrojtjes civile të bashkisë tënde



Çfarë të bësh GJATË tërmetit

Nëse je në një vend të mbyllur:

- Qëndro në kornizën e një dore që ndodhet në mur mbajtës (zakonisht më i trashë), afër një muri mbajtës ose poshtë një trau, ose strehohu nën një krevat apo tryezë të fortë
- Në qendër të dhomës mund të goditesh nga objekte që bien, copëza suvaje, tavane të varura, mobilie etj. Mos dil me ngut, prit sa të ndalojë lëkundja.
- Ki kujdes për pasojat e mundshme të tërmetit: shembje urash, rrëshqitje dherash, rrjedhje gazi etj.

Nëse je në një vend të hapur:

- Qëndro larg ndërtesave, pemëve, shtyllave dhe linjave elektrike: mund të goditesh nga tjegulla, vazo apo materiale të tjera që bien.

Çfarë të bësh PAS tërmetit

- Sigurohu për gjendjen shëndetësore të personave përreth dhe, nëse është e nevojshme, ofro ndihmën e parë
- Para se të dalësh, fik gazin, ujin dhe energjinë elektrike, dhe vish këpucët.

Kur të dalësh, mos përdor ashensorin dhe bëj kujdes me shkallët që mund të jenë dëmtuara.

Sapo të dalësh jashtë, mbaj një sjellje të kujdesshme.

- Përdor sa më pak telefonin, vetëm për raste të domosdoshme
- Mos përdor makinën për të mos penguar kalimin e mjeteve të emergjencës
- Shko drejt zonave të grumbullimit të përcaktuara në planin e mbrojtjes civile të bashkisë

PËRMBYTJET



Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj përmbytjeve, një nga rreziqet më të zakonshme dhe me ndikim të gjerë në territor. Reshjet intensive mund të kenë pasojë të konsiderueshme në rrjedhjen e lumenjve, përrrenjve, kanaleve dhe rrjeteve të kanalizimeve, me pasojë më të rënda në zonat urbane, por jo vetëm. Në këto vende jo vetëm që është më i madh përqendrimi i njerëzve, ndërtesave dhe infrastrukturës, por shpesh aktiviteti njerëzor e modifikon territorin duke rritur rrezikshmërinë.

Sistemi hidrografik i Shqipërisë përbëhet nga 11 lumenj kryesorë me 152 degë dhe përrenj të mëdhenj. Territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në 7 basene ujore kryesore administrative, si më poshtë:

- Baseni ujq Drin–Bunë, me qendër në Shkodër
- Baseni ujq Mat, me qendër në Lezhë
- Baseni ujq Ishëm, me qendër në Durrës
- Baseni ujq Erzen, me qendër në Tiranë
- Baseni ujq Shkumbin, me qendër në Elbasan
- Baseni ujq Seman, me qendër në Fier
- Baseni ujq Vjosa, me qendër në Vlorë



Çfarë duhet të dish?

Të dish nëse zona ku jeton, punon apo qëndron është në rrezik përmbytjeje të ndihmon të parandalosh dhe të përballosh më mire situatat emergjente. Mbaj mend:

- Është e rëndësishme të njohësh cilat janë përmbytjet tipike të territorit tënd
- Nëse ka pasur përmbytje në të kaluarën, ka gjasa që të ndodhin sërish
- Në disa raste është e vështirë të përcaktohet saktësisht kur dhe ku do të ndodhin përmbytjet, dhe mund të mos kesh kohë të reagosh në kohë
- Është e rëndësishme të njohësh kuptimin e kodeve me ngjyra të sistemit të alarmit (jeshile, e verdhë, portokalli dhe e kuqe)
- Gjatë një përmbytjeje, uji mund të ngrihet shumë shpejt, madje një ose dy metra për pak minuta
- Disa vende përmbytjen përpara të tjerave. Në shtëpi, zonat më të rrezikuara janë bodrumet, katet gjysmë nëntokësore dhe katet e para; jashtë, më të rrezikuara janë nënkalimet, segmentet pranë digave dhe urave, rrugët me pjerrësi të fortë dhe përgjithësisht zonat më të ulëta në raport me territorin përreth
- Forca e ujit mund të dëmtojë rëndë ndërtesa dhe infrastrukturën (ura, digat, argjinaturat), dhe ato që janë më të brishta mund të rrëzohen papritur.

Çfarë duhet të bësh?

Edhe ti, me veprime të thjeshta, mund të ndihmosh në uljen e rrezikut nga përmbytjet:

- Respekto ambientin dhe njofto bashkinë për mbeturina të mëdha, tombino të bllokuara, kanale të penguar etj.
- Informohu mbi Planin e Mbrojtjes Civile të bashkisë tënde për të ditur cilat janë zonat e rrezikuara, rrugët e evakuimit dhe zonat e sigurta në qytetin tënd.
- Nëse ti ose një familjar i yt ka nevojë për ndihmë të veçantë (persona me aftësi të kufizuara, të moshuar), njofto bashkinë.
- Informohu për alarmet që jepen nga njësitë qendrore dhe vendore dhe mbi masat që ndërmerr bashkia.
- Përgatit një kuti emergjence me, për shembull, kopje dokumentesh, ndihma të shpejta, elektrik dore, radio me bateri, ujë etj.
- Shmang ruajtjen e sendeve me vlerë në bodrume apo kate gjysmë të nëndheshme.



Çfarë të bësh GJATË paralajmërimit

Në këtë fazë, kur jepet një alarm/paralajmërim, është e mundur të kryhen disa veprime parandaluese për të reduktuar rrezikun:

- Informohu mbi situatat e rrezikut të parashikuara në territorin tënd dhe mbi masat e marra nga Bashkia ku banon.
- Mos fli në bodrume apo ambiente gjysmë-nëntokësore dhe shmang qëndrimin në to.
- Mbro ambientet që ndodhen në nivelin e rrugës dhe mbyll derën e bodrumeve, garazheve e mjediseve gjysmë-nëntokësore vetëm nëse nuk i ekspozon vetes ndaj rrezikut.
- Nëse duhet të lëvizësh, vlerëso më parë rrugën dhe shmang zonat e përmblytshme.
- Mendo mirë nëse ia vlen të mbrosh makinën apo sende të tjera: mund të jetë e rrezikshme për jetën tënde.
- Ndaj me të tjerët çfarë di për këto situata dhe veprimet e sakta që duhen ndjekur.
- Kontrolllo nëse shkolla e fëmijës tënd është informuar për situatën paralajmëruese dhe nëse është e përgatitur për të zbatuar planin e emergjencës.

Çfarë të bësh GJATË përmblytjes

Nëse je në ambient të hapur:

- Qëndro larg zonave të përmblytura: për shkak të shpejtësisë me të cilën rrjedh uji, edhe disa centimetra mund të të rrëzojnë.
- Shko shpejt në një zonë të afërt më të lartë, shmang terrenet me pjerrësi apo ledhe artificiale që mund të rrëshqasin.
- Strehohu në katet e sipërme të një ndërtese.
- Mos përdor makinën: edhe disa centimetra ujë mund të të bëjnë të humbasësh kontrollin ose të fiket makina. Rrezikon të mbetesh i bllokuar.
- Mos kaloni në nënkalime, diga apo ura: qëndrimi apo kalimi në këto vende mund të jetë shumë i rrezikshëm.
- Ki kujdes ku ecën: mund të ketë gropa, të çara, kapakë pusetash të hapura etj.



Çfarë të bësh PAS përmytjes

- Ndiq udhëzimet e autoriteteve para se të marrësh ndonjë veprim, si rikthimi në shtëpi, heqja e baltës, zbrazja e ujit nga bodrumet etj.
- Kontrolllo nëse mund të rindezësh gazin dhe energjinë elektrike. Nëse është e nevojshme, kërkoni ndihmën e një tekniku.
- Para se të përdorësh sistemet e shkarkimit të ujërave, sigurohu që rrjetet e kanalizimeve, gropat septike dhe pusët nuk janë dëmtuar.
- Mos ec nëpër rrugë të përmytura: mund të ketë gropë të mëdha, pusët të hapura apo kabllot elektrike të prera. Gjithashtu, uji mund të jetë i ndotur nga karburantet apo substanca të tjera.
- Ki kujdes edhe në zonat ku uji është tërhequr: baza e rrugës mund të jetë dobësuar dhe të shembet.
- Para se të pish ujë nga rubineti, sigurohu që nuk ka ndalime apo paralajmërime nga autoritetet. Nëse tubacionet janë prekur nga uji i përmytjes, mund të jenë ndotur.

ZJARRET PYJORE



Shqipëria është një vend i ekspozuar ndaj rrezikut të lartë të zjarreve pyjore, për shkak të kushteve klimatike mesdhetare dhe ndikimeve mjedisore që favorizojnë përhapjen e flakëve. Në rajonet qendrore dhe jugore, ku verat janë të thata dhe me temperatura të larta, zjarret ndodhin kryesisht gjatë muajve të verës. Por edhe në rajonet veriore dhe në zonat malore, rreziku është i pranishëm gjatë dimrit, veçanërisht kur vegjetacioni thahet nga ngricat.

Zjarret përbëjnë një kërcënim serioz për burimet natyrore, jetën e egër, pasuritë bujqësore dhe asetet ekonomike, duke përfshirë pyjet, kullotat, ullishtet, pemishtet, vreshtat dhe objektet banesore apo infrastrukture. Prandaj, rreziku nga zjarret pyjore kërkon vëmendje dhe veprim të përbashkët nga institucionet dhe qytetarët.

Cfarë duhet të dish?

Zjarret në pyje, në shumicën e rasteve, kanë origjinë njerëzore. Për këtë arsye, shumë e rëndësishme të sillesh me përgjegjshmëri dhe kujdes ndaj mjedisit dhe territorit ku jeton:



- mos ndiz kurrë zjarr jashtë zonave të posaçme; nëse ke nevojë të djegësh krasitje ose mbetje bujqësore nëtokën tënde, ndiq gjithmonë udhëzimet e bashkisë
- nëse ndodhesh në një zonë pikniku ku është e lejuar ndezja e barbecue-ve, ki kujdes maksimal dhe mos e lër zjarrin të pashuar
- para se të largohesh sigurohu që zjarri është shuar plotësisht dhe merr me vete mbeturinat e tua, të cilat, përveçse dëmtojnë mjedisin, përbëjnë një material shumë të rrezikshëm për përhapjen e flakëve

Çfarë duhet të bësh?

Edhe ti, me veprime të thjeshta, mund të përgatitesh më mire për të përballuar një emergjencë të mundshme:

- Informohu mbi Planin e Mbrojtjes Civile të bashkisë tënde për të ditur çfarë parashikohet për rastet e zjarreve pyjore
- Kujto se ndërhyrja e menjëhershme ështëelbësore nërast zjarri pyjor. Nëse sheh një zjarr, ose edhe vetëm tym, mund të kontaktosh:
- Shërbimin Zjarrfikës (128).
- Numrat e autoriteteve rajonalë për raste të veçanta

Tregoji saktësisht bashkisë apo institucioneve të tjera vendore vendndodhjen ku ndodhet zjarri dhe detaje të tjera të dobishme për lokalizimin e saktë.

Çfarë të bësh PËR TË PARANDALUAR një zjarr pyjor

- Mos hidh cigare apo shkrepëse të ndezura: mund të ndezin barin e thatë.
- Mos ndiz zjarre në pyll apo jashtë zonave të përshtatshme. Mos e lër zjarrin pa mbikëqyrje dhe para se të largohesh sigurohu që është fikur.
- Nëse parkon makinën, sigurohu që marmita të mos prekë barin e thatë: mund të ndizet.
- Mos digj, pa masat e duhura të sigurisë, kallamishte, kashtë apo mbetje të tjera bujqësore. Brenda pak minutash zjarri mund të dalë jashtë kontrollit.
- Nëse fryn erë, mos ndiz zjarr në asnjë rast.
- Mos lër mbeturina në pyll apo në zona të paligjshme: janë lëndë shumë të rrezikshme për zjarr.


Çfarë të bësh NËSE VËREN zjarr në pyll

- Nëse sheh flakë, apo edhe vetëm tym, telefononi menjëherë autoritetet dhe zjarrëfiksen.
- Mos mendo se dikush tjetër ka njoftuar tashmë.
- Jep informacion të saktë për vendndodhjen e zjarrit.

Çfarë të bësh NËSE JE I PËRFSHIRË në një zjarr në pyll

- Kërko një rrugë shpëtimi të sigurt: një rrugë apo një rrjedhë uji. Mos qëndro në zona drejt të cilave fryn era, pasi mund të mbetesh i rrethuar nga flakët.
- Shtrihu përtokë në një vend ku nuk ka bimësi të ndezshme. Tymrat ngjiten lart, kështu që kështu shmang frymëmarrjen e thellë.
- Nëse nuk ke zgjidhje tjetër, përpiku të kalosh përmes zjarrit atje ku flaka është më pak intensive, për të kaluar në anën që është tashmë e djegur. Kjo të çon në një zonë më të sigurt.
- Mos qëndro përgjatë rrugës së zjarrit: pengon kalimin e ekipeve të shpëtimit.

RRËSHQITJET E TOKËS



Rrëshqitjet i përkasin rreziqeve gravitacionale që ndodhin në terrene të pjerrëta për shkak të faktorëve natyrorë si reshjet intensive, erozioni, tërmetet apo ndërhyrja e pakontrolluar njerëzore. Mund të ndodhin papritur dhe të përfshijnë edhe ortekë bore në zonat malore.

Shqipëria është një vend me terren të thyer dhe klimë që favorizon këto fenomene. Shpyllëzimi, ndërtimet pa plan, devijimi i shtretërve të lumenjve dhe shfrytëzimi i guroreve e shtojnë ndjeshëm rrezikun.

Çfarë të bësh PËR TË PARANDALUAR një rrëshqitje:

- Mos ndërto në terrene të pjerrëta apo në shpatet e kodrave, pa leje dhe pa studime e vlerësim gjeologjik.
- Mbill pemë në zona të ekspozuara – rrënjët ndihmojnë në stabilizimin e tokës.
- Shmang hedhjen e mbetjeve që bllokojnë kanalet natyrore të ujit – uji l bllokuar gërryen shtresat e nëntokës.
- Informohu për sinjalet paralajmëruese si çarje në tokë, pjerrësi të ndryshme ose lëvizje të murit rrethues
- Respekto distancat e sigurisë nga digat, argjinaturat, përrrenjtë dhe rrugët me risk.



Çfarë të bësh GJATË një rrëshqitje:

Në ambiente të jashtme:

- Largohu menjëherë nga ndërtesat, pemët, shtyllat dhe linjat elektrike.
- Mos ec në një zonë ku sapo ka ndodhur një rrëshqitje – materiali i tokës mund të zhvendoset sërish.
- Mos qëndro në fund të shpateve ose në rrjedhën e rrëshqitjes.
- Mos drejto mjetin në rrugë me rrëshqitje – rreziku i aksidentit është i lartë.

Në ambiente të brendshme:

- Qëndro brenda dhe mbrohu nën një tavolinë të fortë apo pranë kolonave mbajtëse.
- Largoju dritareve dhe dyerve me xhama.
- Mos përdor ashensorin – mund të bllokohet.
- Fëmijët të njohin planin e evakuimit në shkollë.

Çfarë të bësh PAS rrëshqitjes:

- Mos u rikthe menjëherë në banesë – kërko vlerësim nga autoritetet.
- Raporto çdo rrëshqitje te autoritetet: bashkia ose emergjenca civile.
- Mos përdor rrugë të dëmtuara – ato mund të shemben.
- Verifiko linjat e gazit, ujit dhe energjisë para përdorimit.
- Ndhmo fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe fqinjët që kanë nevojë dhe ndiq udhëzimet për rehabilitim.

BLLOKIMET NGA RRESHJET E DENDURA TË DËBORËS DHE ORTEKËT



Ortekët janë rrëshqitje të shpejta të dëborës në zona malore, që ndodhin pas reshjeve të mëdha, erërave të forta ose për shkak të ndryshimeve klimatike të befasishme.

Shqipëria ka risk të përjetojë ortekë sidomos në Alpet shqiptare dhe zonat malore juglindore. Çdo vit ndodhin izolime të komuniteteve për shkak të ortekëve apo dëborës së madhe.

Çfarë të bësh **PARA** bllokimit nga dëbora:

- Ndiq parashikimet meteorologjike dhe shmang zonat me rrezik ortekësh gjatë dimrit.
- Siguro mjetet e komunikimit, ngrohjes dhe ushqimit për disa ditë izolim.
- Siguro rezerva ushqimore, ujë dhe dru për ngrohje për të paktën 15 ditë.
- Izolo tubacionet e ujit.
- Mbaj veshje të ngrohta, bateri rezervë dhe radio.

Çfarë të bësh **GJATË** ortekut ose bllokimit:

- Qëndro brenda dhe siguro ngrohjen e ambientit.
- Ndhmo fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Qëndro i informuar nga mediat, bashkëpunohet me autoritetet.
- Mbaj rrugicat e brendshme të oborrit të shtëpisë të hapura dhe ndihmo komunitetin.

Çfarë të bësh **PAS** ortekut:

- Pastro çatitë nga dëbora e rëndë për të shmangur shembjen.
- Informohu për hapjen e rrugëve përpara se të lëvizësh.
- Jepu ndihmë fqinjëve, bashkëpunohet dhe angazhohet me autoritetet për rehabilitim dhe raporto dëmet.

RISKU TEKNOLOGJIK



Rreziqet teknologjike janë fatkeqësi dhe aksidente të shkaktuara nga aktivitetet industriale apo infrastrukturat kritike (rafineritë, minierat, depozitat e gazit, impiantet energjetike, etj.).

Në pjesën më të madhe, rreziku teknologjik dhe rreziqet përkatëse lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet që i referohen infrastrukturës kritike si fushat e energjisë, transportit, telekomunikacionit, furnizimit me ujë, etj.

Në Shqipëri risqet teknologjike janë përgjithësisht me ndikim të konsiderueshëm, por mundësia e shfaqjes konsiderohet e ulët ose shumë e ulët. Edhe pse ndodhin rrallë, pasojat e tyre janë të rënda dhe kërkojnë ndërhyrje të specializuara.

Çfarë të bësh PËR TË PARANDALUAR:

- Identifiko dhe informohu nëse banon ose punon në afërsit të zonave me rrezik industrial.
- Respekto udhëzimet dhe sinjalistikën e vendosur nga autoritetet ose institucionet.



Çfarë të bësh GJATË një aksidenti teknologjik:

- Evakuohu menjëherë sipas udhëzimeve të autoriteteve.
- Mbyll dritaret dhe sistemet e ventilimit nëse ke kontakt me gazra ose substanca të dyshimta.
- Qëndro i qetë dhe përdor maska ose rroba që mbulojnë fytyrën nëse është e nevojshme.

Çfarë të bësh PAS aksidentit:

- Mos u rikthe në zonë pa konfirmim zyrtar nga autoritetet dhe institucionet.
- Mos konsumo ujë ose ushqim nga zona deri në analizat përkatëse.
- Bashkëpunohet me autoritetet për matjen e ndotjes dhe masat e rikuperimit.

EPIDEMITË



Risqet biologjike vijnë nga viruset, bakteret, parazitët, sëmundjet e transmetuara nga uji, ajri, ose insektet dhe kafshët tek njeriu. Përfshijnë pandemitë dhe epidemitë (si COVID-19, fruthi, etj.).

Ato mund të rezultojë në emergjenca dhe fatkeqësi. Ato shkaktojnë humbje të konsiderueshme të jetës, prekin mijëra njerëz, mund të shkaktojnë humbje të mëdha ekonomike përmes humbjes së gjësë së gjallë dhe kulturave bujqësore, si dhe mund të shkaktojnë dëmtim dhe humbje të burimeve natyrore, duke përfshirë të faunës dhe florës së rrezikuar.

Çfarë të bësh PËR TË PARANDALUAR:

- Praktiko higjienë të duarve dhe ventilim të ambienteve.
- Ruaj distancën në raste epidemish.
- Mos udhëto në zona të infektuara pa nevojë.
- Eduko fëmijët për zakone higjienike që në shkollë.



Çfarë të bësh GJATË një shpërthimi biologjik:

- Ndiq udhëzimet e autoriteteve dhe ministrisë së shëndetësisë.
- Përdor maska dhe laj dhe dezinfekto duart rregullisht.
- Mos përhap panik – bazohu në informacion të verifikuar.
- Qëndro në kontakt me mjekun për vaksinim ose trajtim.
- Izolohu nëse je i infektuar.
- Raporto simptomat dhe kërko ndihmë mjekësore.

Çfarë të bësh PAS epidemisë:

- Monitoro shëndetin tënd familjes dhe komunitetit që të rrethon.
- Kërko forcimin e sistemit lokal të kujdesit shëndetësor.
- Kërko vazhdimin e fushatave të edukimit për parandalim.

ÇARJA E DIGAVE



Dështimi i digave është rrëzimi i befasishtëm ose gradual i strukturave që mbajnë ujë (liqene, hidrocentrale), që mund të shkaktojë përmbytje të menjëhershme.

Dështimi i një dige ndodh për shkak të shkatërrimit strukturor, përmbytjeve ekstreme apo mungesës së mirëmbajtjes. Mund të ndodhë pa paralajmërim dhe të shkaktojë përmbytje të menjëhershme dhe shumë të rrezikshme. Në Shqipëri ka shumë diga dhe rezervuarë të ndërtuar që nga vitet '60

Çfarë të bësh PËR TË PARANDALUAR:

- Mos ndërto shtëpi, biznese apo infrastruktura në zonat poshtë digës ose në zonë rreziku.
- Njihu me planin e evakuimit të komunitetit në rast çarje dige.
- Kërkoju autoriteteve të mirëmbajnë dhe të inspektojnë digat në territor.

Çfarë të bësh GJATË çarjes së digës:

- Evakuohu menjëherë në një zonë të lartë, pa pritur ndihmë nga jashtë.
- Mos ec dhe mos drejto mjetin në ujëra që rrjedhin me shpejtësi, janë tepër të rrezikshme.
- Mos përdor ura, tunele apo rrugë që ndodhen në drejtimin e ujit.

Çfarë të bësh PAS çarjes së digës:

- Mos u rikthe në zonën e përmbytur derisa të konfirmohet siguria.
- Raporto çdo dëmtim strukturor, sidomos të rrjetet e ujit, energjisë ose kanalizimeve.
- Mbështet dhe angazhohu në përpjekjet e komunitetit për pastrim dhe rehabilitim.

Vullnetar

- Bashkohu me ekipin e mbrojtjes civile të zonës ku jeton
- Trajnim, udhëzime dhe mjetet bazë për detyrat
- Punë në ekip me institucionet vendore
- Kujdes i veçantë dhe mbrojtje e shtuar për grupet më të cënueshme

- 1** Çdo shtetas mund të kontribuojë vullnetarisht në menaxhimin e fatkeqësive dhe zvogëlimin e pasojave.
- 2** Vullnetarët angazhohen individualisht ose në grupe të organizuara, në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.
- 3** Përfshirja në parandalim, përgatitje dhe reagim gjatë emergjencave bëhet sipas situatës dhe nevojave, e rregulluar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Regjistrohu si vullnetar pranë autoriteteve vendore / Bashkisë dhe ndihmo komunitetin tënd të jetë më i sigurt.

*Së bashku Përgatitemi,
Së bashku Mbrojmë*

Fushatë e promovuar dhe realizuar nga:



Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e projektit RESEAL të UNDP Shqipëri:



Sweden
Sverige



Marrin pjesë në fushatën “MBROJTJA CIVILE NË TURNE”

përfaqësues nga institucione publike dhe qeveritare në nivel qendror dhe vendor, organizata vullnetare të mbrojtjes civile, shoqata dhe grupe rajonale.



MBROJTJA CIVILE NË TURNE

është një fushatë komunikimi publik mbi praktikat e mira të mbrojtjes civile, e bazuar në bashkëpunimin midis shkencës, vullnetarizmit dhe institucioneve.

Kjo fushatë u drejtohet të gjithëve, me mesazhe të qarta dhe të dallueshme, për të shndërruar ndërgjegjësimin në veprim, 365 ditë në vit.

www.akmc.gov.al



www.akmc.gov.al



 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

 agjencia_mbrojtjes_civile

 Agjencia Kombetare e Mbrojtjes Civile



0800 0911
Qendra e Kontaktit